



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

Numri i lëndës: 2020:142639
Datë: 20.11.2020
Numri i dokumentit: 01288294

P.nr.788/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, nëpërmjet gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit H. K a Gjilani, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës(KPRK-ës)¹, stë cilin me autorizim e mbrojtës avokatja Vlora Berisha nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1706/2020 e datës 26.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe jo publik, me datë 04.11.2020 mori dhe shpalli, këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari H. K , nga babai B., nëna N., i lindur me dten ... me vendbanim në Gjilan shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, punon si taxi privat, i gjendjes së varfër ekonomike.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.06/L-074, i datës 23 nëntor 2018, i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 14.10.2020, rreth orës 11:00h në Gjilan, në shtëpinë familjare, i akuzuari H. K me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor me gyp plastike-mjet i rrezikshëm i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë, ka shkaktuar dhunë në familje duke lënduar lehtë të dëmtuarën-vajzën e tij A. K, në atë mënyrë që për shkak të mllefrit pse e dëmtuara menjëherë nuk kishte shkuar të blinte bukë si i akuzuari i kishte kërkuar, i njejtë revoltohet dhe del në oborr merr një gyp plastike me të cilin e godet disa herë në kokë, krahë, shpinë dhe pjesë të ndryshme të trupit, mirëpo ndërhyr babai i tij dhe e ndanë, por i akuzuari i revoltuar e godet përsëri me gypin e njejtë në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore në formë të gjak mbledhjes së dy parakrahëve dhe krahëve, gjak mbledhje në regjionin e shpindës, të evidentuara në raportin mjekësor nr... të dt. 14.10.2020 të lëshuar nga Spitali Regjional i Gjilanit që sipas ekspertizës mjekoligjore cilësohen si dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-Me çka ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-ës.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 4, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës, lidhur me nenin 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale(KPP-ës)², të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 2(dy)viteve, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim edhe atë nga data 14.10.2020 e deri më 04.11.2020, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Masa e paraburgimit e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate PPr.nr.182/2020 i datës 15.10.2020, i ndërprehet me datë 04.11.2020.

Detyrohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30€(tridhjetë)Euro, shumën prej 20€(njëzet)euro, për ekspertizë mjekësore si dhe shumën prej 30€(tridhjetë)Euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita pasuese kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIMI

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 26.10.2017, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën PP.II.nr.1706/2020 të datës 26.10.2020 kundër të akuzuarit H. K nga

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

Gjilani, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK.

Gjykata me datë 04.11.2020 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit, Leonora Kadriu, përfaqësuesi i ZMNV-së ..., e dëmtuara A. K³, i akuzuari H. K me mbrojtësen e tij av. Vlora Berisha, në të cilën seancë i akuzuari, pas leximit të akt aktakuzës nga ana e prokurorit, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-ës.

Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari H. K , ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 248 të KPP-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në peiudhën verifikuese prej 2 viteve, nuk kryen vepër tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71, dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se i njëjti është penduar thellë dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, po ashtu gjykata ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata e mori për bazë se me veprimet e tij tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë dhe

³ Nuk I është bashkangjitur ndjekjes penale dhe ka deklaruar se nuk do të paraqet kërkesë pasurore juridike.

ankthë, shkallën e përgjegjesisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, ku kohëve të fundit ky llojë i veprave penale është në rritje.

5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjesisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit të lartcekur, duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjesisë së tyre.

Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin i tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Llogaritje e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Në 79 paragrafi 1 të KPRK-ës parashihet se “*Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë*”, andaj në rastin konkret i akuzuari i lartcekur, ka qëndruar nën masën e paraburgimit edhe atë nga data 14.10.2020 deri më datë 04.11.2020, dhe në rast se revokohet dënimim me burgim me kusht, i njejtë do të llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30€(tridhjetë)Euro, shumë prej 20€(njëzet)euro, për ekspertizë mjekësore si dhe shumë prej 30€(tridhjetë)Euro, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita pasuese kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.788/2020
Me datë 04.11.2020

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore në kopje të mjaftueshme.

Numri i lëndës: 2020:142639
Datë: 20.11.2020
Numri i dokumentit: 01288294